



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKAKOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Prilbjen / Protuto Received / Delivered	06.05	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIPMESHOK	2663	/2022	113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.286/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.286/2022 të datës 25.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adrese banim

kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 06.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.286/2022 e datës 25.03.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. OBLIGHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, t’i bëjë plotësim ndryshim e aktit të emërimit të ankuesit të datës 11.04.2014.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën “Zyrtar Vërtetues-Çertifikues” në Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datën 15.02.2022 i është drejtuar me Njesisë së Burimeve Njerëzore me kërkesën e bashkangjitur të datës 21.12.2021 të nënshkruar edhe nga Sekretarit i Përgjithshëm për ngritjen e koeficientit dhe pagesën retroaktive prej periudhës kohore 01/2015.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 09.03.2022 i ka kthyer ankuesit e-mailin me opinionin e bashkangjitur ligjore të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB.

Ankuesi me datën 25.03.2022 ka parashtrua ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimore që ti bëhet harmonizimi i koeficientit për pozitën “Zyrtar Vërtetues-Çertifikues” nga koeficienti tetë (8) sa e ka aktualisht t’i bëhet nëntë (9) si dhe kompensimi në mënyrë retroaktive nga muaji janar 2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 31.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa me datën 07.04.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritator administroj këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1594/2022 të datës 25.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Akt emërimit e ankuesit të datës 11.04.2014; E-mailin e datës 09.03.2022 dërguar nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 15.02.2022 dërguar nga ankuesi për _____ Kërkesën e ankuesit të datës 21.12.2021 me numër prot:5441/21; Kërkesën e ankuesit të datës 20.11.2020; Kërkesën e ankuesit përmes e-mailit të datës 26.08.2020 dërguar _____ Shkresën e Departamentit për Administrimit e Shërbimit Civil/MAP e datës 27.11.2014; Konkursin e brendshëm për pozitën Zyrtar Çertifikues me numër ref:RN00001178; Kërkesën e ankuesit të datës 25.05.2017; E-mailin e datës 20.09.2017 dërguar nga _____ për _____ Emailin e datës 25.09.2017 dërguar nga _____ për _____ e konkursit i datës 08.06.2018; E-maili e datës 16.03.2021 dërguar nga _____ për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.03.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 07.04.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar Vërtetues-Çertifikues; E-mailin e datës 25.09.2017 dërguar nga _____ për _____ E-mailin e datës 20.09.2017 dërguar nga _____ E-mailin e datës 08.03.2022 dërguar nga ankuesi për _____ E-mailin e datës 21.02.2022 dërguar nga _____ për _____

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____ është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të akti të emërimit të ankuesit të datës 11.04.2014, ka gjetur se i njëjti e mban pozitën “Zyrtar Vërtetues-Çertifikues” me koeficient tetë (8), ndërsa në bazë të shkresës me numër të protokollit:6038 të datës 27.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i DASHC-së, i Ministrisë së Administratës Publike, është konstatuar po ashtu se për pozitën “Zyrtar Çertifikues” koeficienti duhet të jetë nëntë (9). Po ashtu sipas shkresës së datës 14.08.2020 dërguar nëpërmjet e-mailit për ankuesin nga zyrtari i Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB është konstatuar fakti se shkresa me numër të protokollit:6038 të datës 27.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i DASHC-së, i Ministrisë së Administratës Publike është ende në fuqi.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me harmonizimin e koeficientit për pozitën “Zyrtar Vërtetues-Çertifikues”, Kolegji konstaton se organi i punësimit është i obliguar që të veprojë në pajtim me nenin 9, paragrafi 1. Ligji nr. 03/l-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë , ku përcaktohet se: “Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës” dhe ti bëjë ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit, duke i ndryshuar edhe koeficientin nga tetë (8) duhet të bëhet nëntë (9) ngase organi i punësimit është i obliguar që të veprojë në këtë mënyrë me qëllim të zbatimit të nenin 3, paragrafi 2. Ligji nr. 03/l-147për Pagat e Nëpunësve Civilë , ku përcaktohet se: “2. Institucionet e



administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë” sepse në bazë të shkresës së Ministrisë së Administratës Publike, me nivelin e pozitës dhe përshkrimin e detyrave të punës, është konstatuar se për pozitën “Zyrtar Çertifikues” koeficienti duhet të jetë nëntë (9), dhe të bëhet trajtimi për të gjithë nëpunësit civil në mënyrë të barabartë që mbajnë pozitën e lartë cekur, ndërsa ankuesi deri në momentin e parashtrimit të ankesës në Këshill për punën e njëjtë ka qenë duke u pagur me koeficient tetë (8).

Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit që kompensimi t’i bëhet në mënyrë retroaktive për dallimin e pagesës për një (1) koeficient nga periudha kohore janar 2015, ka marr për bazë opinion ligjor të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB dërguar Njesisë së Burimeve Njerëzore me datë 09.03.2022 kërkesën për sqarim lidhur me kërkesën e ankuesit për harmonizimin dhe pagesën retroaktive të koeficientit ku thuhet se: “Në rasti konkret nëse nëpunësi civil nuk e ka realizuar kërkesën e vet është dashur brenda afateve ligjore t’i drejtohet me ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës”, andaj mbi këtë bazë meqenëse ankuesi disa herë kishte parashtruar kërkesa brenda institucionit mirëpo nuk kishte vazhduar tutje me ankesë sipas dispozitave të ligjit material në fuqi, pretendimi i tij ankimor për kompensim në mënyrë retroaktive të dallimit në koeficient nuk mund t’i aprovohet.

Andaj si përfundim, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se organi i punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas pranimit të Vendimit të KPSHCK-së është e obliguar që ta t’ia bëjë plotësim ndryshimin e Aktit të Emërimit sipas të gjeturave në arsyetim pra t’ia harmonizojë koeficientit nga tetë (8) duhet t’ia bëjë nëntë (9), ndërsa nuk është e obliguar t’ia bëjë edhe kompensimin në mënyrë retroaktive.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.286/2022

Flakron Gashi


Zyrtar i Lartë për bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe
- Arkivit të KPSHCK-së.

